



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Prilijeno/Prodato<br>Received/Delivered | 30-05-2023                    | 3                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ/Jedinica<br>Org./Unit                  | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKAMSHICL   | 4514/2023                     |                               | 1/9                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.601/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, sipas ankesës me numër A.nr.601/2023 të datës 03.04.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga Prishtina, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pa bazuar* ankesa me numër A.nr.601/2023 e datës 03.04.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. *Mbetet ne fuqi* Vendimi me numër protokolli 336 i datës 24.03.2023 i Komisionit për Ankesa dhe Njoftimi për kandidatin e suksesshëm me numër protokolli 310 i datës 07.03.2023 i Departamentit për Buxhet dhe Burime Njerëzore në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

A r s y e t i m

Zyra Kombëtare për Auditimit të Përgjithshëm, më datë 10.09.2022 ka rishpall konkursin e jashtëm më numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa”, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku i njëjti i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedure të pranimit.

Auditorja e Përgjithshme pranë këtij institucioni, me datën 27.09.2022, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 1867 për themelimin e Komisionit për Zhvillimin e Procedurave të

Përzgjedhjes për konkursin e jashtëm me numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“.

Bazuar në Raportin Përfundimtar të datës 24.10.2022 të Komisionit të Përzgjedhës, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 69.67 pikë duke u renditur si kandidati i tretë, ndërsa kandidati është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë gjithsej 74.20 pikë, dhe së i njëjti sipas Njoftimit me numër protokollit 2201 të datës 25.10.2022 është shpallur kandidati fitues për pozitën „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“.

Ankuesi i pakënaqur me Vlerësimin e Komisionit të Përzgjedhës, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa ky i fundit me vendimin e kundërshtuar me ankesë gjegjësisht me Vendimin me numër të protokollit 22/2022 të datës 29.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke lenë në fuqi Njoftimin për kandidatin e suksesshëm lidhur me procesin rekrutues me numër reference RZB/ZKA/18-09/22 të datës 07.10.2022, me arsyetimin se nuk ka rritur të argumentoj se ka në këtë proces të rekrutimit ka pasur shkelje sistematike dhe diskriminuese ndaj kandidatëve në testim më shkrim e cila do të cenonte rëndë integritetin dhe kredibilitetin e që rrjedhimisht do të kishte ndikim të theksuar në rezultatin përfundimtar të këtij procesi të rekrutimit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.22/2022 të datës 29.11.2022 të Komisionit për Ankesa, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë, me pretendimet ankimore se Zyra Kombëtare e Auditimit ka dështuar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për kandidatët që i janë nënshtruar testit më shkrim, rrethanë kjo që ka rezultuar me privilegjim të individëve të caktuar duke pasur ndikim direkt në rezultatin final.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 13.01.2023 ka marrë Vendimin me numër protokollit 341/2023 me të cilin ka anuluar të gjitha veprimet administrative procedurale që nga mbyllja e konkursit me numër reference RZB/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“ deri në shpalljen e kandidatit fitues sipas Njoftimit me numër protokollit 2201 të datës 25.10.2022, duke e lenë në fuqi konkursin me numër reference RZB/ZKA/18-09/22 të shpallur me datë 10.09.2022, ndërsa çështjen e kthen në fazën e vlerësimit të aplikacioneve.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm me datën 25.01.2023 ka bërë zbatueshmerin e vendimit të Këshillit të Pavarur ku njofton të gjithë kandidatët se procedura rekrutuese me numër reference RZB/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“ është kthyer në fazën e vlerësimit të aplikacioneve, ndërsa me datën 07.02.2023, nxjerre Vendimin me numër protokollit 156 lidhur me zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes.

Në bazë të Raportit të datës 16.02.2023 të Komisionit për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes në këtë konkurs kanë aplikuar njëzet e dy (22) kandidatë, ndërsa prej tyre 13 (trembëdhjetë) kandidatë i kanë plotësuar kriteret dhe janë ftuar në testin me shkrim për datën 21.02.2023, ku njëri prej tyre ka qenë edhe ankuesi dhe i njëjti i është nënshtruar të gjitha fazave të rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në rezultatet përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ankuesi është vlerësuar me

gjithsej 72.27 pikë të përgjithshme nga (testi me shkrim dhe intervista me goje), duke u renditur i dyti ne listën përfundimtare, ndërsa kandidatja F. Fejza është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë të arritura me gjithsejtë 76.50 pike të përgjithshme nga (testi me shkrim dhe intervista me goje) dhe se e njëjta sipas Njoftimit me numër protokollit 310 të datës 07.03.2023, është shpallur kandidat e suksesshme për pozitën „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin me numër protokollit 310 të datës 07.03.2023 për kandidatin e suksesshëm për pozitën „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“ në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 12.03.2023 parashtron ankesë pranë Komisionit për Ankesa tek organi i punësimit, ndërsa me datën 24.03.2023 Komisioni i Ankesave përmes Vendimit me numër 17/2023 refuzon ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 17/2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit me datën 03.04.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se Zyra Kombëtare e Auditimit ka dështuar në vlerësimin e saktë dhe të drejtë të testit me shkrim, me c' rast ankuesi është dëmtuar me 10.05 pikë në total, dhe se i njëjti pretendon se këto pikë kanë pasur ndikim direkt në përzgjedhjen e kandidatit fitues, sepse sipas tij në testin me shkrim të datës 21.02.2023 është dashur të vlerësohet me 74.5 pikë në total.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Zyra Kombëtare të Auditimit, ndërsa kjo e fundit më datë 24.04.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 4258/2023 të datës 16.05.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushtet për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokollit 3252/2023 të datës 03.04.2023 të parashtruar nga ankuesi V.H në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 336 të datës 24.03.2023 të Komisionit për Ankesa në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm me numër protokollit 310 të datës 07.03.2023 për vendin e punës Zyrtar për Buxhet dhe Financa; Vlerësimi i datës 21.02.2023 me korrespondim prej faqe 1-7; Vlerësimi i datës 11.10.2022 me korrespondim prej faqe 1-10; Kërkesë për përgjigje në ankesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm me numër protokollit 3449/2023 të datës 07.04.2023; Përgjigje në ankesë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 3744/2023 të datës 24.04.2023; Shpalljen e konkursit për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa nga Zyra Kombëtare e Auditimit me datë 10.09.2022; Vendimin me numër protokollit 156 të datës 07.02.2023 të Zyrës Kombëtare të Auditimit;

Vendimin me numër protokolli 156 të datës 03.02.2023 të Zyrës Kombëtare të Auditimit; Vendimin me numër protokolli 143 të datës 01.02.2023 të Zyrës Kombëtare të Auditimit; Vendimin për Themelimin e Komisionit për Zhvillim e Procedurave të Përzgjedhjes me numër protokolli 1867 të datës 27.09.2022 të Zyrës Kombëtare të Auditimit; Raportin për përzgjedhje në test me shkrim për vendin e punës " Zyrtar për Buxhet dhe Financa" me numër protokolli 214 të datës 16.02.2023; Vlerësimi individual i kandidatës F.F i datës 08.02.2023; Vlerësimi individual i kandidatës F.F i datës 04.10.2022; Formulari për pranim të dokumentacionit për aplikim për zyrtar për buxhet dhe financa i kandidatës F.F me numër protokolli 1852 të datës 27.09.2022; Aplikacioni i kandidatës F.F së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës i dërguar me e-mail në " Rekrutimi ZKA" me datë 25.09.2022; Diplomë me numër 1436 e datës 21.04.2006 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik për F.F; Certifikatë me numër 254 e datës 11.11.1999 e lëshuar nga "Zas Trade" për F.F; Certifikatë me numër 1048 e datës 21.02.2000 e lëshuar nga "Zas Trade" për F.F; Certifikatë me numër 472 e datës 09.01.2001 e lëshuar nga "Zas Trade" për F.F; Certifikatë e datës 27.06-01.07.2005 e lëshuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës F.F; Certifikatë e lëshuar nga "Ëus Austria" për F.F; Certifikatë e datës 06-11.07.2005 e lëshuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës për F.F; Letër Referenc për F.F; Njoftim i reduktimit 13.04.2004 për F.F; Referencë profesionale e datës 03.08.2012 e lëshuar nga " Sëdish Armed Forces" për F.F; Referencë profesionale e datës 03.06.2014 për F.F; Letër reference për F.F; Letër reference e muajit Shtator 2005 e lëshuar nga "Sëords Consultancy LTD" për F.F; Letër reference e datës 15.03.2005 e lëshuar nga "KFORI" për F.F; Kopje e Letërnjoftimit e F.F; Certifikatë me numër 15906/2022 e datës 18.07.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për F.F; Formulari i Aplikimit i kandidatës F.F i datës 21.09.2022 për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa; Kartela e punëtorit F.F e lëshuar me datë 06.05.2020 nga Koorporata Energjetike e Kosovës; Certifikatë e datës 21.04.2015 e lëshuar nga "AFAS" për F.F; Certifikatë e lëshuar nga "EXPIK" për F.F; Aplikacioni i kandidatës F.F së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Pasqyra e llogarisë së Trustit për F.F; Shkresë; Vendimin e datës 06.05.2020 të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike për F.F; Vlerësimi individual i kandidatit V.H i datës 08.02.2023; Formulari për pranim të dokumentacionit për aplikim për zyrtar për buxhet dhe financa i kandidatit V.H me numër protokolli 1787 të datës 12.09.2022; Letërnjoftim i V.H i dërguar me e-mail me datë 13.09.2022; Aplikacioni i kandidatit V.H i datës 15.09.2022 i dërguar me e-mail në "Rekrutimi@oagks.org"; Kontrata për marrëdhënien e punës me numër protokolli 3661 të datës 15.09.2022 e lidhur në mes V.H dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vërtetim i datës 15.09.2022 i lëshuar nga "Sound Effect" SH.P.K për V.H; Kontratë pune për kohë të caktuar e lidhur në mes V.H dhe "A&M Clothes" me datë 01.09.2020; Kontratë pune e lidhur në mes V.H dhe "ITX KOSOVO" L.L.C me datë 03.09.2018; Aplikacioni i kandidatit V.H së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës i dërguar me e-mail në [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) me datë 12.09.2022; Formulari zyrtar i konkurrimit i kandidatit V.H 12.09.2022; Certifikatë shëndetësore e datës 25.07.2022 e V.H; Vërtetim i datës 08.09.2022 i lëshuar nga Policia e Kosovës për V.H; Letër rekomandimi e datës 17.01.2018 e lëshuar nga Ministria e Integritimit Evropian për V.H; Letër rekomandimi e lëshuar nga "Kolegji Iliria"-Prof.Dr. L.B për V.H; Letër rekomandimi e lëshuar nga "Kolegji Iliria"-Dr.Sc.N.B për V.H; Letër rekomandimi e lëshuar nga "Kolegji Iliria"-B.K-PhD për V.H; Diplomë me numër 175/17 e datës 07.09.2017 e lëshuar nga "Kolegji Iliria"-Programi për marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci për V.H; Diplomë me

numër 7399 e datës 24.11.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet për V.H; Certifikatë me numër 17544/2022 e datës 26.07.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për V.H; Pasqyra e llogarisë së Trustit e V.H; Vërtetim me Nr.05-711/1-405 i datës 25.07.2022 i lëshuar nga Komuna e Prishtinës për V.H; Pyetjet për intervistën me gojë të datës 03.03.2023 për kandidaten F.F nga 5 anëtarët e komisionit; Pyetjet për intervistën me gojë të datës 03.03.2023 për kandidatin V.H; Vlerësimi i datës 21.02.2023 i Zyrës Kombëtare të Auditimit; Vlerësim i datës 21.02.2023 i Zyrës Kombëtare të Auditimit; Vendimi me numër protokoli 4258 të datës 16.05.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shtyrjen e afatit prej 10 ditësh punë lidhur me vendimmarrje të ankesës A.nr.601/2023; Prova shtesë të dërguara me e-mail nga D.S për I.M-SH me datë 16.05.2023; Kërkesë e datës 16.05.2023 e dërguar me e-mail nga I.M-SH për D.S; Kërkesë e datës 13.01.2023 e dërguar me e-mail nga I.M-SH për D.S; Kërkesë e datës 13.01.2023 e dërguar me e-mail nga I.M-SH për D.S; Kërkesë e datës 11.01.2023 e dërguar me e-mail nga D.S për I.M-SH; Kërkesë e datës 10.01.2023 e dërguar me e-mail nga I.M-SH për D.S; Kërkesë e datës 06.01.2023 e dërguar me e-mail nga D.S për I.M-SH; Kërkesë e datës 05.01.2023 e dërguar me e-mail nga I.M-SH për D.S; Akt Emërim me numër protokoli 47 të datës 19.01.2021 i lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për L.O; Shtojcë e Akt Emërimit me numër protokoli 277 të datës 17.12.2021 të lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për L.O; Kontratë pune me numër protokoli 74 të datës 24.01.2020 e lidhur mes Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe G.N; Shtojcë e kontratës së punës me numër protokoli 316 të datës 23.12.2021 e lidhur mes Zyra Kombëtare e Auditimit dhe G.N; Akt emërim me numër protokoli 2086 i datës 11.10.2021 i lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për N.K-A; Vlerësimi i datës 21.02.2023 i lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit me korrespondim prej faqe 1-8; Njoftim i dërguar me e-mail i datës 22.05.2023 nga D.S për I.M-SH; Njoftim i dërguar me e-mail i datës 22.05.2023 nga Rekrutimi ZKA për D.S; Njoftim i dërguar me e-mail i datës 07.03.2023 i dërguar nga Rekrutimi ZKA për F.B; Njoftim për kandidatin e suksesshëm F.F me numër protokoli 310 të datës 07.03.2023 të lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Nënshkrimi i pjesëmarrësve në testin me shkrim i datës 21.02.2023; Nënshkrimi i pjesëmarrësve në intervistë me gojë i datës 03.03.2023; Njoftimi dhe listat i dërguar me e-mail me datë 22.05.2023 nga D.S për KPMSHCK-në.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankuesit Valmir Hoxha është e pabazuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit duke ju referuar Aktgjykimit në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese, konstatoi se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020 dhe se me dispozitat e nenit 32 paragrafi 3 të të njëjtit ligj përcaktohet se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji,*

Rrjedhimisht, nga analizimi i Aktgjykimit në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën 207 ka konstatuar se: *Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në*

*Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre...".*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 paragrafin 1, me të cilin është përcaktuar se: *"Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm për Auditorin e Përgjithshëm, Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm, Ndihmës Auditorët e Përgjithshëm dhe Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil".*

Nga administrimi i provave materiale rrjedh se Zyra Kombëtare e Auditimit, më datë 10.09.2022 ka rishpall konkursin e jashtëm më numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku i njëjti i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedure të pranimit.

Sipas Konkursit me numër reference RZBF/ZKA/18-09/22, si kritere/kërkesa për pozitën e shpallur janë përcaktuar: *Diploma e fakultetit dhe dy(2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë pune në planifikim dhe analiza.* Ndërsa lidhur me dokumentacion e aplikimit janë përcaktuar: *Formulari i aplikimit, Dokument i identifikimit, dëshmi lidhur me arsimin dhe përvojën e punës, dëshmi nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë si dhe dëshmi se nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës të dërguara nga organit i punësimit dhe ankuesi gjegjësisht në bazë të Raportit të datës 16.02.2023 të Komisionit për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes ka konstatuar se këtë procedurë të rekrutimit kanë aplikuar njëzet e dy (22) kandidatë, ndërsa prej tyre 13 (trembëdhjetë) kandidatë i kanë plotësuar kriteret dhe njëherëit janë ftuar për testin me shkrim për datën 21.02.2023. Në testin me shkrim kane marr pjesë 5 kandidatë, ku në mesin e tyre ka qenë edhe ankuesi dhe i njëjti nga Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes është vlerësuar me 64 pikë ndërsa kandidatja fituese është vlerësuar me 71.5 pike. Pas njoftimit të rezultatit të testit me shkrim kandidatet ju kane nënshtruar intervistës me gojë dhe bazuar në rezultatet përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 72.27 pikë të përgjithshme nga (testi me shkrim dhe intervista me goje), duke u renditur i dyti në listën përfundimtare, ndërsa kandidatja F. Fejza është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë të arritura me gjithsejtë 76.50 pike të përgjithshme nga (testi me shkrim dhe intervista me goje) dhe se e njëjta sipas Njoftimit me numër protokoll 310 të datës 07.03.2023 është shpallur kandidat e suksesshme për pozitën „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar dosjes se rekrutimit, gjegjësisht Raportit të datës 16.02.2023 ka konstatuar se Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes në Zyrën Kombëtare të Auditimit, përpilimin e listës së ngushtë e ka hartuar brenda afateve ligjore siç parashihet me dispozitat e nenit 17 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku përcaktohet se: *"Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes brenda 5 (pesë) ditëve, pas pranimit të dokumenteve për konkurrim nga DBBNJ i shqyrton dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkurs e harton listën e*

*kandidateve të cilët ftohen për testim me shkrim” dhe po ashtu vlerësimi i kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në pajtim me kriteret e konkursit dhe nenin 36 të Rregullores (ZKA)Nr.02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit.*

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës të dërguara nga organit i punësimit, lidhur me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara të konkursit, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomën me numër Nr.1436 të datës 21.04.2006, sipas së cilës dëshmohet se e njëjta me datën 18.04.2006 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe ka marrë titullin Ekonomist i Diplomuar, si dhe në bazë të dëshmive në dosje e njëjta e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës ngase sipas Kartelës së Punëtorit të datës 06.05.2020 të lëshuar nga Korporata Energjetike e Kosovës, rrjedh se e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën 01.11.2008 deri me datë 08.05.2013 në pozitën “Zyrtare për Hulumentim Tregu”, ndërsa nga data 08.05.2013 deri më muajin maj 2016 e njëjta ka punuar në pozitën “Zyrtare e Prokurimit” tek KEDS, po ashtu kjo përvojë dëshmohet edhe me Pasqyrën e Llogarisë-Trustin, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se kandidatja e përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në konkursin e datës 10.09.2022 ndërlidhur me kualifikimin dhe përvojën e punës profesionale.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes në Zyrën Kombëtare të Auditimit nuk i ka bërë vlerësim real, të sakte dhe të drejte testit me shkrim me c ‘rast ankuesi pretendon se është dëmtuar me 10.5 pikë në total, pikë të cilat kanë pasur ndikim direkt në përzgjedhjen e kandidatit fitues, dhe se i njëjti pretendon se në testin me shkrim të datës 21.02.2023 është dashur të vlerësohet me 74.5 pikë në total, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dëshmitë e datës 16.05.2023 të dërguar nga organi i punësimit konkretisht çelësin e pyetjeve të testit me shkrim, testin e ankuesit dhe testin e kandidatës së përzgjedhur, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshme sepse Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes ka vepruar drejtë duke bërë hartimin dhe vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesin, po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur dhe i njëjti testin me shkrim dhe pyetjet e intervistës me gojë i ka hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafit 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 dhe neni 4 si dhe nenit 19 paragrafit 3 nën paragrafi 3.1 nën nënparagrafi 3.1.1, 3.1.2, 3.1.3 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku përcaktohet se: „3. Komisioni e harton testin me shkrim, përmbajtja e të cilit duhet të mbetet konfidenciale deri në momentin e mbajtjes së testimit. Totali i pikëve nga testi me shkrim është njëqind (100) pikë. 3.1.Përbërja e testit me shkrim: 3.1.1. Njohuri e përgjithshme (20%); 3.1.2.Pyetje rreth aftësive dhe personalitetit (30%); 3.1.3.Pyetje që lidhen me vendin e punës (50%). 3.2.Formati i pyetjeve: 3.2.1.Pyetje të shumëfishta; 3.2.2.Në formë të eseve. 4. Komisioni i përgatitë përgjigjet në pyetjet e hartuara dhe e përcakton normën vlerësuese me pikë për çdo përgjigje të dhënë nga kandidati” si dhe nenin 19 paragrafi 3 ku përcaktohet se; Komisioni i përgatitë pyetjet e intervistës dhe e përcakton normën vlerësuese me pikë për çdo përgjigje të dhënë nga kandidati. Totali i pikëve nga intervista është njëqind (100) pikë. 3.1.Përbërja e Intervistës: 3.1.1. Pjesa e testimit të personalitetit dhe planeve profesionale (15%); 3.1.1 Njohuri të përgjithshme institucionale (15%); 3.1.2 Pyetje rreth aftësive dhe shkathtësive (30%); 3.1.3. Njohuri që lidhen me vendin e punës (40%)”, po ashtu kandidatja e përzgjedhur edhe ankuesi janë vlerësuar në mënyrë individuale nga secili anëtar i komisionit përzgjedhës lidhur me piket e fituara, siç përcaktohet me Rregulloren (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, përkatësisht me nenin 18 paragrafin 4 dhe nenin 19 paragrafin 3, andaj mbi

këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar dhe si i tillë nuk ka mbështetje ligjore.

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se në bazë të vlerësimeve nga Komisioni gjegjësisht rezultatit nga dy fazat e (testit me shkrim dhe intervistës me gojë) në renditjen përfundimtare rezulton se ankuesi është renditur i dyti me 72.27 pikë, ndërsa kandidatja fituese rezulton se ka arritur 76.50 pike përfundimtare, e cila në baze të përformancës së dy fazave ka rezultuar si konkurrenca e suksesshme me më shumë pikë të arritura me gjithsejtë 76.50 pike të përgjithshme nga (testi me shkrim dhe intervista me gojë) dhe se e njëjta sipas Njoftimit me numër protokoll 310 të datës 07.03.2023 është shpallur konkurrenca e suksesshme për pozitën „ Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Zyrën Kombëtare të Auditimit, andaj në kuptim të saj Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes dhe Zyra Kombëtare e Auditimit kanë vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 7 dhe 8, nenin 19 paragrafin 4 dhe nenin 20 paragrafi 3 të Rregullores (ZKA) Nr.03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit i cili përcakton se: *Shpallja për kandidatin e suksesshëm behet në tabelën e shpalljeve dhe faqen elektronike zyrtare të ZKAS-së. Secili pjesëmarrës në testim njoftohet individualisht për rezultatin përmes postes elektronike. Njoftimi përmban edhe informatat për të drejtën e ankimit“.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ndërlidhur me faktet e prezantuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare lidhur me pozitën e punës për „ Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ka vepruar drejtë kur ka vlerësuar përvojën profesionale të konkurrencës së përzgjedhur si dhe të ankuesit pasi që i njëjti po ashtu i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe janë përfshirë në listën e ngushtë, dhe po ashtu vlerësimet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë sikurse për ankuesin, dhe për konkurrencën e përzgjedhur, janë bërë pajtim me Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Andaj bazuar në konstatimet e dhëna si më lartë është vërtetuar fakti se pretendimet ankimore të ankuesit për anulimin e Njoftimit të datës 07.03.2023 për kandidatin e suksesshëm për pozitën „ Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Zyrën Kombëtare të Auditimit, janë të pa bazuara, për faktin se procedura e rekrutimit për pozitën përkatëse të punës, nga shpallja e konkursit të datës 10.09.2022, deri tek përzgjedhja përfundimtare e konkurrencës, është zhvilluar në pajtim me Rregulloren (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Rregulloren (ZKA) Nr.02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, si dhe Ligjit Nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht Komisioni për Ankesa në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 336 të datës 24.03.2023 ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material.

Kështu që, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132



paragrafi 2 të Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.601/2023

Ilire Mehmeti Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit ;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën Kombëtare të Auditimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.